

DITARI MUJOR

SHTATOR 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

DISKUTIME PËR TË ARDHMEN EVROPIANE, MINISTRJA PIRDENI NË DANIMARKË

Ministrja Pirdeni, mori pjesë në Takimin joformal të Ministrave për Çështjet Evropiane të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve kandidate, i mbajtur në Kopenhagë, me fokus të veçantë në procesin e zgjerimit të BE-së. Në fjalën e mbajtur, ministrja Pirdeni theksoi nevojën për një qasje sistematike drejt anëtarësimit të shpejtë, përmes përfshirjes graduale në tregun e përbashkët dhe në institucionet ku diskutohen politikat e BE-së. Ajo nënvizoi se ky proces duhet të ecë paralelisht me rigorozitetin e domosdoshëm në përmbushjen e detyrimeve që e bëjnë vendin anëtar të plotë në Bashkimin Evropian.



MINISTRJA PIRDENI NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE "DIPLO 2025"



Ministrja Pirdeni mori pjesë në konferencën e Ambasadorëve shqiptarë nëpër botë "Diplo 2025". Konferenca me titull "Shqipëria 2030: në Evropë, e ndërlidhur me botën", u zhvillua në formën e paneleve me pjesëmarrjen e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë. Diskutimet u fokusuan në integrimin evropian të Shqipërisë dhe të rajonit, diplomacinë ekonomike, si edhe në çështjet e sigurisë rajonale e globale. Ministrja Pirdeni ishte pjesë e panelit së bashku me Ministren e Shtetit dhe Kryenegociatoren, Znj. Majlinda Dhuka, dhe Z. Adrian Kamenica, Drejtor i Departamentit të Politikës dhe Informimit Evropian në Zyrën e Kryeministrit. Panelistët shkëmbyen me ambasadorët e Shqipërisë në botë prioritetet për rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian.

NJË TJETËR HAP PËRPARA NË RRUGËTIMIN DREJT BE-SË PËR SHQIPËRINË, HAPEN 4 KAPITUJ TË RINJ

Në Bruksel u zhvillua Konferenca e 6-të Ndërqeveritare Shqipëri-Bashkimi Evropian, e thirrur me ftesë të Presidencës daneze të BE-së. Konferenca ishte e përqendruar tek grup-kapitulli IV: "Agjenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme". Ministrja Pirdeni ishte pjesë e delegacionit shqiptar që kryesohej nga Kryeministri Z. Edi Rama, me prezencën e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatores Znj. Majlinda Dhuka, si dhe një delegacion të përbërë nga negociatorët përgjegjës për kapitujt përbërës. Shqipëria hedh kështu një tjetër hap të rëndësishëm drejt anëtarësimit në BE, pasi këta 4 kapituj u shtohen 24 kapitujve të negociatave për anëtarësim, që janë hapur në vetëm 11 muaj.



ADMINISTRATAT PUBLIKE TË RAJONIT NË FOKUS: MINISTRJA PIRDENI NË KONFERENCËN E KE NË PODGORICË



Ministrja Pirdeni, mori pjesë në konferencën ministrore "Kapacitetet e administratave publike për integrim në Bashkimin Evropian dhe më tej", e organizuar nga Komisioni Evropian me mbështetjen e SIGMA-s. Në konferencë morën pjesë ministra dhe përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Moldavia dhe Armenia, si dhe nga organizatat rajonale dhe ndërkombëtare si ReSPA, OECD, RCC dhe WEBER. Gjatë fjalës që mbajti në konferencë, ministrja Pirdeni prezantoi përvojën e Shqipërisë në ndërtimin e kapaciteteve dhe përgatitjen, trajnimin e stafeve të administratës publike për t'i bërë ballë procesit tejet intensiv të anëtarësimit në BE, ku kryefjalë mbetet inovacioni.

DITARI MUJOR

SHTATOR 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

TRYEZË E RRUMBULLAKËT PËR VLERËSIMIN E RISKUT TË INTEGRITETIT NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS

MAPA, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion (DPAK), çelën konsultimin publik për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në ASHK me grupet e interesit. Tryeza mbledhi përfaqësues nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilët ndanë sugjerime mbi masat për garantimin e integritetit në çdo hallkë të punës së ASHK-së. Në aktivitet morën pjesë drejtues të ASHK-së, përfaqësues të shoqërisë civile, Delegacionit të BE-së, Dhomës së Avokatisë, Dhomës së Noterisë, NAREA-s dhe sektorit bankar. Në fjalën e saj, Ministria Pirdeni, theksoi: "Hartimi i Planit të Integritetit, si pjesë e masës së parë 'Lufta kundër korrupsionit', është një nga iniciativat më të rëndësishme të MAPA, pjesë e angazhimeve që Shqipëria ka marrë në kuadër të Agjendës së Reformave dhe Planit të Rritjes së BE-së".



TRYEZË DISKUTIMI ME GRUPET E INTERESIT MBI PROJEKTLIGJIN "PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE"



MAPA në bashkëpunim me ILDKPI, organizuan një tryezë të rrumbullakët me partnerët evropianë, përfaqësues nga institucionet publike, sektori privat dhe shoqëria civile, me qëllim formësimin e projektligjit "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve", pjesë e procesit të përafrimit me BE-në, synon të forcojë integritetin dhe llogaridhënien përmes forcimit të mbrojtjes së sinjalizuesëve, në funksion të rritjes së raportimit të praktikave të paligjshme.

Në fjalën e saj, ministria Pirdeni theksoi se kuadri i ri strategjik 2024–2030 vendos theksin te qasja parandaluese në luftën kundër korrupsionit, duke nënvizuar se sinjalizimi përbën një mekanizëm të rëndësishëm si në parandalimin ashtu edhe në reagimin ndaj shkeljeve. Ajo shtoi se sinjalizimi rrit transparencën, forcon besimin e qytetarëve te institucionet dhe kontribuon në mbrojtjen e tyre.